



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1101 / Prot.
3

Tiranë, më 16 11 2016

REKOMANDIM

Nr. 30 datë 16 11 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit Hotel "Palace Htl & Spa"- Sara El sh.p.k. Durrës, në përfundim të të cilit,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr.219, datë 12.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli pranë kontrolluesit Hotel "Palace Htl & Spa" - Sara El sh.p.k. Durrës, konform procedurave administrative, me objekti kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Hotel "Palace Htl & Spa" - Sara El sh.p.k. Durrës.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.219, datë 12.10.2016 të Komisionerit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi e ka kryer Njoftimin në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi aplikon mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit dhe nuk ka vendosur tabela informuese.
3. Kontrolluesi nuk aplikon Deklarata Konfidencialiteti me punëmarrësit.
4. Kontrolluesi nuk ka rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Kontrolluesi disponon, një arshivë elektronike me të dhënat personale të klientëve, duke tejkaluar qëllimin fillestar për të cilin janë grumbulluar.
6. Kontrolluesi nuk aplikon politikat e privatësisë në portalin zyrtar: www.palacchotel.com.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 5, 6, 18, 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formular Njoftimi i kontrolluesit *Hotel “Palace Htl & Spa” - Sara El sh.p.k. Durrës.*
- Fotografi të ambienteve.
- Ekstrakt i QKB-QKR.
- Printim nga portali www.palacchotel.com.
- Listëpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, etj.

Në përmbyllje të procesit administrativ, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën se: *“Po merren masat e nevojshme në vazhdimësi për të zbatuar me korrektësi maksimale sa më shpejt. Shpresoj të na jepet kohë, dhe kërkesa jonë të merret në konsideratë.”*

1. Mungesa e një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, do të thotë mungesë masash paraprake, me qëllim shmangien e shkeljeve. Mungesa e rregullores dhe deklaratës së konfidencialitetit përbëjnë shkelje të parashikuara në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, konkretisht në nenin 27 të tij, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma “dh” i cili shprehet: *“...kontrolluesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë”.*
2. Mungesa e tabelave informuese në ambientet ku instalohen dhe veprojnë kamerat e vëzhgimit (CCTV), mungesa e rubrikës “Politikat e privatësisë”, përbëjnë shkelje të nenit 18 të Ligjit, Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma “b”, i cili shprehet: *“...kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 300 000 lekë.*

Grupi i hetimit konstatoi se, gjatë ushtrimit të aktivitetit të kontrolluesit *Hotel “Palace Htl & Spa” - Sara El sh.p.k. Durrës*, ndër format e ndryshme të grumbullimit të të dhënave manuale dhe elektronike, ai grumbullon dhe ruan të dhëna nëpërmjet kopjimit apo skanimit të dokumenteve identifikuese të klientëve, duke krijuar një *data base* elektronik të përhershëm.

Ky grumbullim të dhënash, në këndvështrim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën shkelje të neneve 5 dhe 6 të tij, pasi qëllimi fillestar mbi shërbimin e hotelerisë në shumicën e rasteve finalizohet me pagesën nga ana e klientit për shërbimin e ofruar, parashikuar kjo në Kreun III, "Të dhëna të detyrueshme", pika 4 e Udhëzimit Nr.10, datë 06.09.2011, për "Përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere", i cili shprehet:

"Hoteli ruan të dhëna personale vetëm për një periudhë kohore që është e nevojshme me qëllim ofrimin e rezervimit të tij dhe strehimit apo shërbimeve të tjera të kërkuara. Pas mbarimit të kësaj periudhe, të dhënat personale ruhen vetëm për qëllime të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të ligjshme të hotelit, veçanërisht nëse shërbimet hoteliere janë objekt i procesit gjyqësor, ose klienti refuzon të kryejë pagesën".

Zyra e Komisionerit gjithashtu sjell në vëmendje kreun IV të këtij udhëzimi, "Kopjimi i kartave të identitetit apo dokumenteve të udhëtimit", i cili shprehet:

"Kopjet të kartave personale të identitetit apo dokumentit të udhëtimit, pasaportës, të grumbulluara dhe/ose të marra, mund të përpunohen vetëm nëse klienti të cilit i janë lëshuar këto dokumente, ka shprehur qartë me shkrim pëlqimin e tij, sipas aneksit 1 të këtij udhëzimi, si dhe me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet nga ana e organeve publike, të cilët e kanë këtë të drejtë nga legjislacioni në fuqi.

Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij".

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", datë 30.04.2015, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Hotel "Palace Htl & Spa" sh.p.k. Durrës, në ushtrim të së drejtës për tu dëgjuar është njoftuar zyrtarisht, për pjesëmarrje në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 10.11.2016.

Kontrolluesi Hotel "Palace Htl & Spa" - Sara El sh.p.k. Durrës, gjatë seancës dëgjimore, ka dokumentuar masat e marra për riparimin e konstatimeve nga grupi i kontrollit si depozitimi i Rregullores dhe i Deklaratës së Konfidencialitetit, akte të cilat plotësojnë mangësitë e gjetura.

Zyra e Komisionerit, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit, i cili ka qenë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neni 31, pika 1, gërma "a/1",

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Hotel "Palace Htl & Spa" - Sara El sh.p.k. Durrës, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën "Politikat e Privatësisë".
2. Kontrolluesi Hotel "Palace Htl & Spa" - Sara El sh.p.k. Durrës, në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
3. Kontrolluesi, Hotel "Palace Htl & Spa" - Sara El sh.p.k. Durrës, brenda një periudhe 10 (dhjetë) ditore nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi, të marrë masat për shkatërrimin e të dhënave personale të grumbulluara në mënyrë të paligjshme.
4. Kontrolluesi, Hotel "Palace Htl & Spa" - Sara El sh.p.k. Durrës, ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit, mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ky akt. Plotësimi i këtyre detyrimeve, mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 16.11.2016

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI

